

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe sekretaren juridike Minire Krasniqi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] të cilin e përfaqëson prindi [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED]” nr. [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] të cilin e përfaqëson prindi [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED]” nr. [REDACTED], lidhur me kompensimin e dëmit, vlera kontestit 2.450,00 Euro, jashtë seancës me datë 28.03.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia)

REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], ushtruar kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] lidhur me kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij [REDACTED] me datë 02.03.2015, ka ushtruar padi kundër të paditurit për shkak të kompensimit të dëmit.

Përfaqësuesi i palës paditëse [REDACTED] me parashtresën e datës 28.03.2018, e ka tërhequr kërkesëpadinë për faktin se nuk është i interesuar që të zhvilloj këtë procedure më tutje.

Procedura civile zhvillohet me vullnetin e palëve ndërgjyqëse. Parimi i disponibilitetit në procedurën civile është ndër ma kryesorit për zhvillimin dhe përfundimin e një çështjeje juridike civile. Sipas këtij parimi paditësit i njihet e drejta që procedurën civile të iniciuar me padi t'a përfundoj me tërheqje të padisë apo me heqje dorë nga kërkesëpadia apo me pajtim gjyqësor-ujdi.


Dispozita e nenit 149 paragrafi 1 parasheh “Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë”, ndërsa paragrafi 2 parasheh “Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet

pëlqimi i palës së paditur". Në këtë rast kemi të bëjmë me veprim procedural të palës paditëse dhe si i tillë i nënshtrohet dispozitave të LPK-së, përkatësisht nenit 149. Për dhënien e aktgjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia si kusht elementar është heqja dorë nga kërkesëpadia, në këtë rast pala paditëse e ka përdorur termin tërheqje në tërësi të padisë dhe kërkesëpadië dhe këtë Gjykata e ka vlerësuar si heqje dorë nga kërkesëpadia. Aktgjykimi mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia Gjykata e nxjerrë pavarësisht se të njëjtin a e ka kërkuar pala paditëse apo jo, mjafton të heqë dorë nga kërkesëpadia. Në këtë rast Gjykata ka konstatuar se pala paditëse disponon lirisht me kërkesat për të cilat ka hequr dorë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.129/15, me datë 28.03.2018



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

REPUBLIKA E KOSOVES  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE I OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

Më 28.03.2018
Dana 28.03.2018

